



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.5, datë 5.2.2007

**PËR
CAKTIMIN E NJËSIVE BASHKIAKE SI AGJENT TATIMOR PËR MBLEDHJEN E
TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE SI DHE PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E
PUNONJËSVE NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE.**

Në mbështetje të Ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ndryshuar me Ligjin nr.9208, datë 18.03.2002, neni 10, neni 16, pika 2, 3 dhe 4, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të caktojë Njësitë Bashkiake në qytetin e Tiranës si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si më poshtë:
 - a) Taksa për pasurinë e paluajtshme:
 - a/1) Taksa mbi ndërtesën për kategorinë e familjarëve,
 - a/2) Taksa e tokës bujqësore.
 - b) Taksa e përkohshme e gjelbërt për kategorinë e familjarëve,
 - c) Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë e familjarëve,
 - d) Tarifa e parkimit të automjeteve për parkimet orare ditore jo të rezervuara.
2. Njësitë Bashkiake përfitojnë 10 % të të ardhurave të arkëtuara nga taksat dhe tarifat për pikat "1/a/1", "1/b" dhe "1/c" dhe "1/d"si dhe 20% të të ardhurave për pikat "1/a/2".
3. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të përgatitet dhe të nënshkruhen akt-marrëveshjet me agjentët tatimorë të përcaktuar në këtë Vendim.
4. Për zbatimin e pikës 1, të miratojë një shtesë prej dy punonjësish në strukturën organizative të çdo Njësie.
5. Paguesa e punonjësve të kryhet sipas lidhjes së pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për çdo Njësi Bashkiake duke i klasifikuar në kategorinë "4/a".
6. Efektet financiare të përfshihen në buxhetin e vitit 2007.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Juridike dhe të gjitha Njësitë Bashkiake.
8. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI